

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Shqipe Qerimi, anëtarë, me zyrtarin ligjor Visar Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit V.M., nga fshati ..., Komuna e Glllogocit, për shkak të veprës penale të sulmit nga neni 187 par 3 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, av. G.P., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, P.nr.57/2018, të dt.31.01.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 31.05.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit V.M., av. G.P., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, P.nr.57/2018, të dt.31.01.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, P.nr.57/2018, të dt.31.01.2018, është shpallur fajtor i akuzuari V.M., për shkak të veprës penale të sulmit nga neni 187 par 3 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, mirëpo me pëlqimin e të akuzuarit, dënimi me burgim është zëvendësuar me dënimin me gjobë në shumën prej 1000 (njëmijë) €, të cilin dënim është obliguar që ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, kurse në rast mos pagese në afatin e caktuar, atëherë dënimi me burgim do të ekzekutohet në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve.

Në dënimin e shqiptuar i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt.13.01.2018 gjerë me dt.31.01.2018, që nënkupton në kohëzgjatje prej 19 (nëntëmbëdhjetë) ditëve.

E dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale, sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, paushallin gjyqësor në shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, si dhe shumën prej 30 (tridhjetë) €, për programin për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë mbrojtësi i të akuzuarit V.M., av. G.P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të anulohet, dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje, ose i njëjti të ndryshohet, dhe kundër të akuzuarit të nxirret aktgjykim lirues.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/II.nr.518/2018, të datës 16.05.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar, ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit V.M., av. G.P., nuk është e bazuar.

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat shkelje konsistojnë në kuptim të nenit 384 par 1 pika 1.7 lidhur me par 2 pika 2.1 dhe 2.2 të KPPK, duke theksuar se i akuzuari raportet me bashkëshorten e vet i ka normalizuar, se tani jetojnë në bashkësi martesore së bashku me tre fëmijët e vet, andaj, si rezultat i mos vlerësimit të duhur të gjendjes faktike, janë bërë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kanë ndikuar edhe në marrjen e vendimit për dënimin. Përndryshe, gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar në mënyrë të duhur rrethanat përkitazi me vendimin për dënimin sikurse parasheh neni 73 dhe 74 të KPK. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar në masë të duhur të gjitha rrethanat lehtësuese, e sidomos ato posaçërisht lehtësuese sikurse janë, se i njëjti është i gjendjes së rëndë ekonomike, ka tre fëmijë dhe vazhdimisht përkujdeset për ta, nuk ka angazhime në punë, përpos punës fizike, se të gjitha këto rrethana kanë ndikuar që në këtë çështje penale me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, gjendja ekonomike edhe më shumë rëndohet.

Kolegji i kësaj gjykate, ka vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar dhe ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë adresuar sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par 1 pika 1.7 lidhur me par 2 pika 2.1 dhe 2.2 të KPPK, por ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale nuk janë bërë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, për të cilat kjo gjykatë përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten si dhe me arsyetimin, ngase përmban faktet vendimtare të cilat e karakterizojnë veprën penale të sulmit nga neni 187 par 3 të KPK. Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e nxjerrë në tërësi dhe plotësisht e ka gjykuar lëndën e akuzës, sipas së cilës edhe është mbajtur shqyrtimi gjyqësor, e kjo është vërtetuar edhe nga pranimi i të akuzuarit përkitazi me fajësinë, i cili pranim është bërë në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore. Gjithashtu, në këtë çështje penale kolegji i kësaj gjykate vlerëson se dispozitat ligjore janë zbatuar në përpikëri si dhe janë respektuar të drejtat e të akuzuarit sikurse janë të parapara, andaj, edhe aktgjykimi është përpiluar në kuptim të nenit 370 të KPPK, sa i përket përmbajtjes dhe formës së paraparë me shkrim, ngase gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se janë plotësuar të gjitha faktet që e karakterizojnë veprën penale, dhe

ka dhënë arsye të qarta dhe të plota, se për çfarë arsye konsiderohen të vërtetuara, dhe ka paraqitur saktësinë e provave përkitazi me zgjedhjen e çështjes penale për ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit, andaj, aktgjykimi i shkallës së parë është i pranueshëm edhe për kolegjin e kësaj gjykate.

Përkundër asaj që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljes së ligjit penal, kolegji i kësaj gjykate të njëjtin e ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare, dhe ka ardhur në përfundim se nuk përfshihet me shkeljet të parapara me nenin 385 të KPPK, sepse gjykata e shkallës së parë të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale e cila është e paraparë në ligjin e aplikueshëm, se nuk ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë të akuzuarin nga ndjekja penale si dhe nga përgjegjësia penale, se ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore.

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuari, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, të akuzuarit nuk i ka shqiptuar dënimin adekuat me peshën e veprës penale, dhe se nuk i ka vlerësuar disa nga rrethanat lehtësuese të cilat janë të parapara në nenin 73 dhe 74 të KPK, përkundër asaj që i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se ka premtuar që në të ardhmen nuk ka me kryer veprë penale, se është penduar për veprën e kryer penale, se ka kërkuar falje nga e dëmtuara, se është mbajtës i familjes, andaj, jemi të mendimit se dënimi i shqiptuar është tejet i rëndë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave e të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, ashtu që kolegji pas vlerësimit të aktgjykimit, vie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se është i gjendjes së varfër ekonomike, mbajtës i vetëm i familjes, se i ka normalizuar raportet me të dëmtuarën dhe jetojnë në shtëpi të përbashkët me tre fëmijë, gjithashtu ka vlerësuar edhe rrethanat rënduese, e sidomos ka vlerësuar se i njëjti edhe më parë ka qenë i dënuar sipas aktgjykimeve P.nr.418/2015 dhe P.nr.324/2016, andaj, pasi që ka vlerësuar këtë rrethanë, e duke patur parasysh intensitetin e kryerjes së veprës penale, si dhe natyrën e saj, e duke vlerësuar ankesën e mbajtësit të akuzuarit, ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka aplikuar edhe nenin 74 të KPK, përkitazi me rregullat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimeve dhe në prani të këtyre rrethanave vihet në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur në këtë çështje penale, dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.511/2018, të datës 31.05.2018

Zyrtari Ligjor
Visar Gashi

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Shqipe Qerimi